

**S T A T U T I**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**«EB-2000» SHPK**

Ne këtë Statut

“**Ligji**” është Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”

“**Statuti**” është statuti i shoqërisë.

**KREU I**

**THEMELIMI,EMRI,OBJEKTI,KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA.**

**Neni 1**

**THEMELIMI DHE EMRI**

Sot më dt.07.03.2018 (dymijë e tetembedhjete ), diten e Merkure , **UNE** ortaku themelues:

ENGJËLL BEQIRAJ, i biri i EQEREM-it , i lindur në 12.01.2000, ne Ballsh , dhe banues në Lagjja 18 Prilli, Rruga Zenel Hekali, Pallati 83/10, Shkalla 1, Apartamenti nr.10 Ballsh, Mallakastër, Qarku Fier, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me pergjegjësi të kufizuar me emrin **“EB-2000” shpk**

Ortaku Themelues i Shoqërisë është: **ENGJËLL EQEREM BEQIRAJ**

**Neni 2**

**OBJEKTI**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

1. Ndertime civile - industriale - turistike - bujqesore deri ne 5 kate dhe mbi 5 kate.
2. Punime carpenterie druri dhe metalike.
3. Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh.
4. Ndertim dhe mirmbajtje te rrugeve, lokale dhe ato nacionale, veshje me asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe.
5. Punime te mirembajtjes sinjalizimit dhe vijezimit ne rruge.
6. Ndertim vepra arti.
7. Ndertim ujesjella e kanalizime, gazsjelisa, linja te tubacioneve te naftes dhe impiantet e tyre.
8. Ndertim vepra kullimi ujitje toke e impiante vaditese.
9. Punime mbrojtje dhe sistemimi hidraulike.
10. Rikonstruksione godina civile e ekonomike, veshje fasadash, lyerje etj, impiante higjeno - sanitare, kuzhina dhe lavanteri dhe mirembajtja e tyre.
11. Punime per ndertimin e impianteve te prodhimit te energjise elektrike.
12. Punime te inxhinierise se mjedisit.
13. Punime speciale ndertim.
14. Punime per sistemimin e sektorit pyjor dhe mbareshtimin e pyjeve.



15. Import - eksport dhe tregtimi me shumice dhe pakice, te artikujve te ndryshem, industrial, buqesor, blektoral, ushqimor, te konfeksiioneve, parkete e mokete, paisje zyrash, duralumini, metaleve, hidrosanitare, elektro shtepiake, elektronike, kondicioner, elektriqe dhe hidraulike, kancelari, paisje kompjuterike.
16. Tregtim dhe prodhim materiale ndërtimi, inerte, rëre, mermer.
17. Tregtim makineri dhe pjesë këmbimi per lloje te ndryshme të makinerive dhe servis per automjete, mjete buqesore, industri si dhe paisje teknologjike
18. Grumbullim dhe tregtim te bimëve medicinal ,Peme dekorative kultivim i tyre, kryerjen e sherbimeve te gjelberimit.
19. Transport mallrash dhe udhetaresh per vete dhe per te tretet.
20. Bar Restorant.
21. Tregtim me shumice dhe me pakice te lendeve djegese, karburantit, dhe druve te zjarrit.
22. Riparim, sherbim, tregtim te ndryshme per paisje elektrike, elektromekanike, elektromjeksore, pompa, ashensore etj.
23. Sherbime dezifikimi 3D ne ambjente te brendeshme dhe te jashtme.
24. Shoqeria ka te drejte te bashkepunoje me persona fizike, juridike, me çdo shoqeri tjeter, brenda dhe jashte vendit. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma, agjensi dhe ndermarje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti.
25. Grumbullim skrapi, demolim, perpunim, tregtim, import.
26. Sherbime pastrimi dhe mirembajtje te ambjenteve te brendshme dhe te jashtme, industrial dhe civile, publike dhe private reklamave e totemeve te ambienteve spitalore, qendrave shendetore, qendrave tregtare, hoteleve, zyrave, aeroporteve, terminaleve etj, me punonjesit tane. Pastrimeve te perditshme, pastrime speciale, pastrime pas rikonstruksiioneve, lyerjeve etj. Larje, pastrim, trajtim, dhe lucidim te dyshemeve te te gjitha llojeve: pastrim te fasadave te te gjitha llojeve ne cdo lloj lartesie. Pastrime dhe trajtime te veprave te artit. Pastrim dhe larje te kolltuqeve, divaneve, karrigeve, te cdo lloj tavani, tapeteve, moketeve, perdeve te holla e te trasha, grilave etj. Sherbime lavanterie dhe hotelerie, larje, hekurosje per cdo lloj subjekti dhe transport I materialeve te pastruara. Sherbime lavazherie per cdo lloj automjeti.
27. Grumbullim, transportim dhe evadim te mbjeteve spitalore dhe mbetjeve te rrezikshme spitalore. Zbatime dhe mirembajtje te impianteve djegese te mbetjeve. Trajtim dhe djegie te mbetjeve urbane e spitalore. Riperdorim te materialeve, makinerive, kompostim dhe prodhim te derivative te djegshme nga mbetjet. Pastrime me mjete teknike special te ujrate, transporti i materialeve te pastruara. Pastrimi i gropave spetike te cdo lloj subjekti dhe transportim i ujerave te ndotura.
28. Sherbime recepsioni dhe mbushje formularesh ne te gjitha nivelet.

### Neni 3

#### **KOHEZGJATJA**

Shoqëria **"EB-2000" shpk**, krijohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një afat kohor të pacaktuar.

### Neni 4

#### **SELIA E SHOQËRISË DHE ADRESA ELEKTRONIKE E SAJ**

- Selia e **"EB-2000" Sh.p.k.** do të jetë: Fier Hekal RROMES Pasuria nr 92/91, shtepia 1 kateshe, zona kadastrale 3191, Rromes Mallakaster

- Adresa Elektronike e Shoqërisë është: **eb2000.shpk@yahoo.com**
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është **eb2000.shpk@yahoo.com**
- Cel: 0682023901

## KREU II

### KAPITALI I RREGJISTRUAR

#### Neni 5

#### VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TË RREGJISTRUAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 lekë**. Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme. Ortaku themelues **ENGJËLL BEQIRAJ**, zotëruesh i 1 pjesë me vlerë të përgjithshme prej 100 000 lekë, që përbën 100% e kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6

#### ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para ose në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroj një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila e merr vendimin në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqsojnë.

#### Neni 7

#### TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqerise;
- Shitblerjes;
- Trashëgimnisë;
- Dhurimit;
- Çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferushme në rruge trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRËSE

#### Neni 8

## **ORGANI VENDIMMARRËS**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet në statut;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen dhe zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proceset e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet ne asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t,u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vone se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarsisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë me shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht,

votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungeses së kuorumit të përmenduar më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vone se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 11

#### MARRJA E VENDIMEVE.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotërueseve të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesëve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve;
  - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 12

#### PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) Dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

#### ADMINISTRIMI

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërrë në kundërshtim më këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Nenshkrimi

### Neni 14

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatisin dhe nënshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryejnë regjistrimet dhe dërgojne të dhënat e detyrushme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojne përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët jane të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rrëziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojne detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shume se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkoje administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 15

#### PËRGJEGJSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administrator detyrohet:

- 1.a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale më ato të shoqërisë;
- d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, si dhe t'i dëmshpërblejë shoqërisë demët, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shume se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë ne mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividentë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftesi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.



Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV**

#### **VITI FINANCIAR-EKSPERTËT**

##### **Neni 16**

##### **VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe perfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

##### **EKSPERTËT**

Eksperti ka për detyrë që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **KREU V**

#### **PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

##### **Neni 18**

##### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
  - Me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
  - Me hapjen e procedurave te falimentimit;
  - Nëse nuk ka krye veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në perputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - Me vendim të gjykatës;
- Ne këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojne mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likujdim e sipër”.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesëve, brënda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 19**

#### **RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### **Neni 20**

#### **BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 21**

#### **MOSMARRËVESHJET**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **ORTAKU**

#### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUR**

**"EB-2000 " SHPK**

**Ortaku**

Engjëll **BEQIRAJ**

